Kuvendit të Komunës ,që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika {d} dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 neni 17 par 17.1 shkronja (a,b,c dhe s) neni 40 Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008 dhe në pajtim me nenin 33 paragrafi 33.1 pika 11 dhe nenit të Statutit të Komunës së Istogut 01.Nr.62/2010, neni 4,5 neni 6 paragrafi 6.1 pika 1.2,neni 7 paragrafi 7.1 neni 8 paragrafi 1.2 si dhe neni 14 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-092 ,Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenit 14 paragrafi 14.4 të Rregullores QRK Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit 03.Nr.1145/23 mbi miratimin e listës së veçante të pronave të komunës së Istogut, si dhe bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor të komunës së Istogut HZK 2024-2032 ne mbledhjen e planifikuar për tu mbajtur më datë 27.12.2024 të miratoj këtë :

V E N D I M P A R A P R A K PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËRMES SHPREHJES SË INTERESIT

Njësitë kadastrale :

Nr.942-0 ZK Osojan me sipërfaqe prej 931959 m²,
 Nr.233-0 ZK Kërrninë me sipërfaqe prej 198029 m²,
 Nr.369-0 ZK Kërrninë me sipërfaqe prej 21740m²,
 Nr.368-0 ZK Kërrninë me sipërfaqe prej 27737m²,
 Nr.372-0 ZK Kërrninë me sipërfaqe prej 62021m²,
 Nr.367-0 ZK Kërrninë me sipërfaqe prej 345200m²,
 Nr.373-0 ZK Kërrninë me sipërfaqe prej 35935m²,
 Nr.1424-0 ZK Shushicë me sipërfaqe prej 112120m²,
 Nr.1420-0 ZK Shushicë me sipërfaqe prej 277115m²,
 Nr.1423-0 ZK Shushicë me sipërfaqe prej 202075m²,
 Nr.1428-0 ZK Shushicë me sipërfaqe prej 168308m²,
 Nr.541-0 ZK Veriq me sipërfaqe prej 123813m²,
 Nr.352-1 ZK Tuqep me sipërfaqe prej 252646m²,
 Nr.540-0 ZK Veriq me sipërfaqe prej 260280m²,
 Nr.982-0 ZK Osojan me sipërfaqe prej 110058m²,
 Nr.981-0 ZK Osojan me sipërfaqe prej 227706m²,
 Nr.499-0 ZK Bellopojë me sipërfaqe prej 193184m²,
 Nr.500-0 ZK Bellopojë me sipërfaqe prej 423940m².

Të gjitha këto parcela të evidentuara sipas certifikatave pronësore prone e komunës së Istogut të epet në shfrytëzim afatgjatë më qellim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publik sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ofertë pas shpalljes publike në ueb faqen e komunës së Istogut.

2.Afati kohor (periudha kohore) për dhënien shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të Komunës përmes shprehjes së interesit të cekur si në piken 1 të këtij vendimi është 30 (tridhjetë) vite.

 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1107/2024	Data: Datum: 17.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e datës 16.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: “Rregullimi i trotuareve në zonat urbane Banjë, Vrellë, Gurakoc dhe Istog”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: “Rregullimi i trotuareve në zonat urbane Banjë, Vrellë, Gurakoc dhe Istog”, me numër të jashtëm prokurimi 633-024-11104-521 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-024-080-521 të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik “**KABASHI**” SH.P.K. dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Besnik Metaj**, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Berat Hasanaj**, anëtar dhe;
- 1.3. **Agim Pacaj**, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës dhe Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIKË OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1106/024	Data: Datum: 16.12.2024	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), bazuar në Nenin 53 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe bazuar në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 09Nr.183/2024 të datës 13.12.2024, të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për plotësim ndryshimin e Vendimit 01Nr.748/2024 të datës 23.09.2024, për verifikimin e punëve për projektet: Lot4 “Betonimi i kanalit të ujitjes vija e Ahmet Agës në Vrellë”; Lot5 “Betonimi i kanalit të ujitjes Baicë-Kashicë”; Lot6 “Betonimi i kanalit të ujitjes Kloka Muzhevinë –Lluga”, nxjerr:

V E N D I M

1. Ndryshohet Plotësohet Vendimit 01Nr.748/2024 i datës 23.09.2024, për verifikimin e punëve për projektet: Lot4 “Betonimi i kanalit të ujitjes vija e Ahmet Agës në Vrellë”; Lot5 “Betonimi i kanalit të ujitjes Baicë-Kashicë”; Lot6 “Betonimi i kanalit të ujitjes Kloka Muzhevinë –Lluga” me numër prokurimi 633-24-044-521 dhe në vend të Fadil Kabashit anëtar i komisionit në pikën 1.2. të Vendimit, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, caktohet Hekuran Rugova.

2. Vendimit 01Nr.748/2024 i datës 23.09.2024, mbetet në fuqi të gjitha pikat tjera.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi dhe zhvillim Rural.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi dhe zhvillim Rural,
- Hekuran Rugova dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. <u>1169</u> /2024	Data: Datum: <u>16.12.</u> 2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016) dhe në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, e ka shqyrtuar kërkesën 06 Nr. 553-44869 të datës 12.12.2024, të parashtruar nga Vesel Zymberaj nga fshati Serbobran, Komuna e Istogut, përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e bashkëshortes së tij Mihane Zymberaj, në QKUK - Prishtinë, Komisioni me procesverbal Nr. 323/2024 të datës 10.12.2024, i propozon Kryetarit, të nxjerr:

V E N D I M

- 1. APROVOHET:** Kërkesa 06 Nr. 553-44869, datë 12.12.2024, e parashtruar nga Vesel Zymberaj, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e bashkëshortes së tij Mihane Zymberaj, në Prishtinë, për trajtimin me 10 seanca për Kimio-Terapi, në QKUK, në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas. I lejohen **100 litra** lëndë djegëse (karburant).
2. Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë Vesel Zymberaj me një vërtetim për furnizim me karburant të automjetit që parashtruesi i kërkesës e prezanton, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi. Ky furnizim duhet të bëhet në përputhje me procedurat e furnizimit me karburant të automjeteve zyrtare që vlen në programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij. Për zbatimin e tij do të përzgjidhen Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë një konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Vesel Zymberaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije Sutaj



Kryetar i Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1104/2024	Data: Datum: 16.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 08Nr.563/2024 të datës 16.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: Lot5 “Ndërtimi i rrethojës së varrezave në Kerrninë –lagja Fekaj dhe Zeqiraj”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: “Ndërtimi i rrethojës së varrezave në Kerrninë –lagja Fekaj dhe Zeqiraj” me numër të jashtëm prokurimi 633-024-5261-521/C906 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-024-030-521, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik **“MENTI” SH.P.K.** dhe në komision caktohen:

- 1.1. Hekuran Rugova,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Blerim Bujupi,** anëtar;
- 1.3. Alban Llapaj,** anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRËDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1103/2024	Data: Datum: 16.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 70 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 13.12.2024 të parashtruar nga Prokurimi për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin: “Ndërtimi i stadiumit Demush Mavraj faza IV punë shtese”, nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: Menaxheri i kontratës operatori “**P.M.N**” **SH.P.K** për projektin: “Ndërtimi i stadiumit Demush Mavraj faza IV punë shtese”, me numër të jashtëm prokurimi 633-024-12949-5-3-5 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-024-093-535 dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxheres së kontratës **CAKTOHET: Vlora Vuthaj**, Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për kontratën e lidhur në mes të Menaxherit të Prokurimit dhe fituesit të tenderit.

2. Menaxheri i kontratave dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratave obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave duke zbatuar A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Prokurimit,
- Operatori “P.M.N” SH.P.K, Menaxher i kontratës,
- Vlora Vuthaj, Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e Menaxherit të kontratës,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1102/2024	Data: Datum: 16.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 13.12.2024 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Ndërtimi i stadiumit Demush Mavraj faza IV punë shtese”; nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Ndërtimi i stadiumit Demush Mavraj faza IV punë shtese”; me numër të jashtëm prokurimi 633-024-12949-5-3-5 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-024-093-535 dhe në komision caktohen.

- 1.1. Drin Sadikaj,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Qefsere Ibrahimaj,** anëtare;
- 1.3. Agim Pacaj,** anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i stadiumit Demush Mavraj faza IV punë shtese”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit t’iu ofroj qasje në oferta që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
Z. FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1101/2024	Data: Datum: 16.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën të datës 16.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: Lot2 “Furnizimi me bari (tepih) sintetik në SHFMU Hysni Zajmi”-Vrellë, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: Lot2 “Furnizimi me bari (tepih) sintetik në SHFMU Hysni Zajmi”-Vrellë, me numër prokurimi 633-024-6025-121/C898, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik “**SHTEPIA G**” **SH.P.K** dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naser Nimanaj,** Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Faton Maraj,** anëtar;
- 1.3. Jahir Dreshaj,** anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftojë Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria Komunale të Arsimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1100/2024	Data: Datum: 16.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtohet kërkesa 06Nr.145/2024 të datës 16.12.2024, e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale për ndarjen e mjeteve buxhetore për pako ushqimore për familjet në nevojë nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime, nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** Kërkesa 06Nr.145/2024 e datës 16.12.2024, e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pako ushqimore për familjet në nevojë në shumë prej **6,930.00€ (gjashtëmijë e nëntëqind e tridhjetë euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.
- Mjetet e ndara në pikë 1 të këtij vendimi do ti transferohen në xhirollogarinë e operatorit ekonomik me të cilin ka kontratë të lidhur komuna, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
- Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
 z.Illir FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1097/2024	Data: Datum: 13.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave financiare në Zyrën e Kryetarit, shqyrtuan kërkesën 01Nr.400-5901/2024 të datës 12.02.2024, të parashtruar nga Albin Murtezaj nga fsh. Shushicë dhe me procesverbal Nr.78/2024 të datës 12.12.2024, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.400-5901/2024 e datës 12.02.2024, e parashtruar nga Albin Murtezaj, për përkrahje financiare, për studimet e Masterit Elektro–und Informationstechink (English-taught program) në University of Applied Sciences në Gjermani dhe i ndahen 500.00€ nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Albin Murtezaj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Albin Murtezaj,
- Drejtoria për Shërbime Publike, dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-1096/024	Data: Datum: 12.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në Nenin 40 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/2023) dhe bazuar në nenin 20 të Rregullores (QRK) NR.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, shqyrtoi kërkesën me 02Nr.239/2024 të datës 12.12.2024 të parashtruar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore, për themelimin e Komisionit të Pranimit, për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën: **“Zyrtar për Komunitetet dhe Mundësi të Barabarta”, dhe “Zyrtar për të Drejtat dhe Riintegrim të Komuniteteve”,** në kuadër të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 02Nr.239/2024 e datës 12.12.2024, e parashtruar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore, për themelimin e Komisionit të Pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën: **“Zyrtar për Komunitetet dhe Mundësi të Barabarta”, dhe “Zyrtar për të Drejtat dhe Riintegrim të Komuniteteve”,** në kuadër të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, me numër reference RN00015708, i publikuar me datën 02.11.2024, me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. **Rasim Mahmutovë,** Kryesues i Komisionit
- 1.2. **Mehmet Čeman,** anëtar;
- 1.3. **Fisnik Shoshaj,** anëtar;
- 1.4. **Brahim Hetemaj,** anëtar;
- 1.5. **Arta Fetahu,** anëtare

2. Anëtar rezervë:

- 2.1. **Delvina Sylaj,** Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. **Emina Coković,** anëtare;
- 2.3. **Drin Sadikaj,** anëtar;
- 2.4. **Qefsere Ibrahimaj,** anëtare;
- 2.5. **Vlora Gjoci,** anëtare.

3. Komisioni i lartcekur do të kryen punët bazuar në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/2023, në Rregulloren (QRK) NR.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren (QRK) NR. 05/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) NR.15/2023 për procedurën e pranimit në shërbimin civil.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do të kryejë Zyra e Burimeve Njerëzore.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij kujdeset: Komisioni i pranimit.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit të pranimit;
- Zyrës Burimeve Njerëzore dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ**

 **Kryetari Komunës
Zllir FERATI**

 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-1095/024	Data: Datum: 12.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në Nenin 40 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/2023) dhe bazuar në nenin 20 të Rregullores (QRK) NR.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, shqyrtoi kërkesën me 02Nr.240/2024 të datës 12.12.2024 të parashtruar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore, për themelimin e Komisionit të Pranimi, për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën: **“Zyrtar për Tatim në Pronë”**, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 02Nr.240/2024 e datës 12.12.2024, e parashtruar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore, për themelimin e Komisionit të Pranimi për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën: **“Zyrtar për Tatim në Pronë”**, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, me numër reference RN00015709, i publikuar me datën 02.11.2024, me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. Fisnik Shoshaj**, Kryesues i Komisionit
- 1.2. Agim Pacaj**, anëtar;
- 1.3. Besnik Metaj**, anëtar;
- 1.4. Emina Coković**, anëtare;
- 1.5. Albert Hasanaj**, anëtar

2. Anëtar rezervë:

- 2.1. Fjollë Berisha**, Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. Kujtesa Berisha**, anëtare;
- 2.3. Brahim Hetemaj**, anëtar;
- 2.4. Kushtrim Gecaj**, anëtar;
- 2.5. Delvina Sylaj**, anëtare.

3. Komisioni i lartcekur do të kryen punët bazuar në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/2023, në Rregulloren (QRK) NR.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil dhe Rregulloren (QRK) NR. 05/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) NR.15/2023 për procedurën e pranimi në shërbimin civil.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do të kryejë Zyra e Burimeve Njerëzore.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij kujdeset Komisioni i pranimi.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit të pranimi;
- Zyrës Burimeve Njerëzore dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
Z. Ilir FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1094/2024	Data: Datum: 12.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën të datës 12.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektet: Lot1 “Ndërtimi i rrugëve në Istog, lagjet e reja dhe lagja Hajzraj në Istog të Poshtëm”, Lot6 “Ndërtimi i rrugëve në Lubozhdë lagja Januzaj dhe Bicaj”; Lot2 “Ndërtimi rrugëve në Prigodë, lagja Gashi Mehaj dhe Qallakovic”; Lot4 “Ndërtimi i rrugëve në lagjen Blakaj dhe Zemaj në Prekallë”; nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektet: Lot1 “Ndërtimi i rrugëve në Istog, lagjet e reja dhe lagja Hajzraj në Istog të Poshtëm”, Lot6 “Ndërtimi i rrugëve në Lubozhdë lagja Januzaj dhe Bicaj”; Lot2 “Ndërtimi rrugëve në Prigodë, lagja Gashi Mehaj dhe Qallakovic”; me numër prokurimi 633-024-8551-521/C929, Lot4 “Ndërtimi i rrugëve në lagjen Blakaj dhe Zemaj në Prekallë”; me numër prokurimi 633-024-7104-521/C910, të cilat projekte i ka realizuar operatori ekonomik **“GRANIT” SH.P.K.** nga Istogu dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Rasim Mahmutović**, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Ardon Arifaj**, anëtar;
- 1.3. **Migjen Maxharraj**, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projekteve të cekura në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektet e lartcekura si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektet e lartcekura e merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
Z. Ilir FERATI

Z. Ilir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-1093/2024	Data: Datum: 11.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), në Ligjin Nr.08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe bazuar në Nenin 68, paragrafi 68.1 pika 2 të Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën Nr.142/2024 të datës 10.12.2024 të parashtruar nga Drejtoresha e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Strategjisë për Përfshirje Sociale në Komunën e Istogut, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Grupi Punues për hartimin e Strategjisë për Përfshirje Sociale në Komunën e Istogut dhe në Grup punues caktohen:

- 1.1. Merita Bytyçi, (DMS), Kryesuese e Grupit Punues;
- 1.2. Jozef Frrokaj, (QPS), anëtar;
- 1.3. Brahim Hetemaj, (DSH), anëtar;
- 1.4. Naim Behlulaj, (DKA), anëtar;
- 1.5. Albet Hasanaj, (DBF), anëtar;
- 1.6. Almina Eco, (ZKKK), anëtare;
- 1.7. Servete Haxhijaj, (ZBGJ), anëtare;
- 1.8. Vlora Gjoci, (ZMF), anëtare;
- 1.9. Regjë Mulaj, përfaqësues i OJQ-së Vision 02, anëtar;

2. Grupi punues i lartcekur obligohet që të hartoj Strategjinë për Përfshirje Sociale në Komunën e Istogut dhe pas përfundimit një kopje të Strategjisë do t'i dorëzoj Kryetarit si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera që janë në natyrën e këtij Grupi Punues.

3. Të gjitha punët juridike-administrative për nevoja të Grupit Punues, do t'i kryej: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

4. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi Punues dhe Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Grupit Punues,
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRËDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1092/2024	Data: Datum: 11.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën të datës 10.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektet: Lot1“Ndertimi i rrugëve në Bajice lagja Ukaj, Loxhaj dhe Morinaj”, Lot2 “Ndërtimi i rrugëve në Cerrcë, rruga livadhet e Buta dhe Lagja Kaliqani”; nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektet: Lot1“Ndertimi i rrugëve në Bajice lagja Ukaj, Loxhaj dhe Morinaj”, Lot2 “Ndërtimi i rrugëve në Cerrcë, rruga livadhet e Buta dhe Lagja Kaliqani”, me numër prokurimi 633-024-7104-521/C910, të cilat projekte i ka realizuar operatori ekonomik **“GRANIT” SH.P.K nga Istogu** dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Rasim Mahmutović**, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Ardon Arifaj**, anëtar dhe;
- 1.3. **Mixhen Maxharraj**, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projekteve të cekura në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftojë Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektet e lartcekura si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektet e lartcekura e merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-1090/024	Data: Datum: 11.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në Nenin 40 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/2023) dhe bazuar në nenin 20 të Rregullores (QRK) NR.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, shqyrtoi kërkesën me 02Nr.235/2024 të datës 10.12.2024 të parashtruar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore, për themelimin e Komisionit të Pranimit, për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën: **“Zyrtar për Gjendje Civile I”**, në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 02Nr.235/2024 e datës 10.12.2024, e parashtruar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore, për themelimin e Komisionit të Pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën: **“Zyrtar për Gjendje Civile I”**, në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale, me numër reference RN00015720, i publikuar me datën 04.11.2024, me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. **Faton Bujupi**, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Fjollë Berisha**, anëtare;
- 1.3. **Agim Pacaj**, anëtar;
- 1.4. **Arta Fetahu**, anëtare;
- 1.5. **Drin Sadikaj**, anëtar.

2. Anëtar rezervë:

- 2.1. **Fisnik Shoshaj**, Kryesues i Komisionit;
- 2.2. **Ardon Arifaj**, anëtar;
- 2.3. **Vlora Gjoci**, anëtar;
- 2.4. **Sami Metaj**, anëtar;
- 2.5. **Faton Bytyçi**, anëtar.

3. Komisioni i lartcekur do të kryen punët bazuar në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/2023, në Rregulloren (QRK) NR.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren (QRK) NR. 05/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) NR.15/2023 për procedurën e pranimit në shërbimin civil.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do të kryejë Zyra e Burimeve Njerëzore.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij kujdeset: Komisioni i pranimit.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit të pranimit;
- Zyrës Burimeve Njerëzore dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PËRSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1089/024	Data: Datum: 11.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne Nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në Nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe paragrafi 5 i Nenit 2 të Rregullores MF-Nr.4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shqyrtoj kërkesën 12Nr.400-44565 të datës 10.12.2024, të parashtruar nga “Klubi i Hendbollit Femrat” nga Istogu, përfaqësues i OJQ-së z.Faruk Shala, për përkrahje financiare dhe me shkresë 12Nr.117/2024 të datës 10.12.2024, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesa 12Nr.400-44565 e datës 10.12.2024, e parashtruar nga “Klubi i Hendbollit Femrat” nga Istogu, përfaqësues i OJQ-së z.Faruk Shala, për përkrahje financiare për organizimin e 20 vjetorit të KHF.Istogu dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **495.00€ (katërqind e nëntëdhjetë e pesë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transvere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ-së “Klubi i Hendbollit Femrat”, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- OJQ-së “Klubi i Hendbollit Femrat”,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.Br. <u>1086</u> /2024	Data: Datum: <u>10.12.2024</u>	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58, pikës b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), si dhe nenit 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), dhe në përputhje me Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave Nr. 68/2021 të miratuar me 29.06.2021, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka shqyrtuar kërkesën 08 Nr.120-31921 të datës 21.08.2024, e paraqitur nga znj. Sofe Berishaj nga Istogu, për ofrimin e ndihmës financiare për shpenzimet e varrimit të familjarit të ndjerë dhe me shkresën 08 Nr.382/2024, të datës 24.09.2024, i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

- MIRATOHET:** Kërkesa 08 Nr.120-31921, datë 21.08.2024, e paraqitur nga znj. Sofe Berishaj, për mbështetje financiare në lidhje me shpenzimet e varrimit për vdekjen e bashkëshortit Faik Berishaj në shumën prej 200,00€ (dyqind euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve fondi burimor 21 - përfitues individual me P.I. kod ekonomik 22202, për shpenzimet e varrimit sipas programit buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike.
- Mjetet e aprovuara në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në llogarinë bankare të znj. Sofe Berishaj, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike.
- Ky Vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë një konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- znj. Sofe Berishaj,
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe
- Arkivit të zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije Sutaj





Kryetari Komunës
 Z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. <u>108</u> /2024	Data: Datum: <u>10.12</u> .2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016) dhe në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, e ka shqyrtuar kërkesën 06 Nr. 553-44522 të datës 10.12.2024, të parashtruar nga Muhamet Pukaj nga fshati Drejë, Komuna e Istogut, përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e bashkëshortes së tij Shkëndije Pukaj, në QKUK - Prishtinë, Komisioni me procesverbal Nr. 323/2024 të datës 10.12.2024, i propozon Kryetarit, të nxjerr:

V E N D I M

- 1. APROVOHET:** Kërkesa 06 Nr. 553-44522, datë 10.12.2024, e parashtruar nga Muhamet Pukaj, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e bashkëshortes së tij Shkëndije Pukaj, në Prishtinë, për trajtimin me 30 seanca për Kimio-Terapi, në QKUK, në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas. I lejohen 300 litra lënde djegëse (karburant).
- Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë Muhamet Pukaj me një vërtetim për furnizim me karburant të automjetit që parashtruesi i kërkesës e prezanton, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi. Ky furnizim duhet të bëhet në përputhje me procedurat e furnizimit me karburant të automjeteve zyrtare që vlen në programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij. Për zbatimin e tij do të përzgjidhen Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
- Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë një konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Muhamet Pukaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01Nr.Br.1084 /2024	Data: 10.12.2024	

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenin 8 të Statutit të Komunës 01.Nr.62/10 të datës 30.11.2010 i :

Propozon

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 5 shkronja (b),11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14.1 dhe 17 (f) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, të datës 30.11.2010; nenit 4 paragrafi 1.21, nenit 23 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.04/L-60 për Mbeturina, Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-071 Për Mbeturina; Rregullores Komunale Nr.1/2023 të datës 27.02.2023; Udhëzimit Administrativ Nr.03/2024 për Kriteret për Zgjedhjen e Lokacionit të Deponive si dhe Kushtet Teknike sipas Destinimit; Ligjit nr.08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe në bazë të dokumenteve të planifikimit hapësinor të Komunës së Istogut, pas ri shqyrtimit të vendimit 00Nr.151/2024 të datës 25.09.2024, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2024 të miratojë këtë:

V E N D I M PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT 00.NR.151/2024 PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E DEPONISË TRANSFER

1. Miratohet- propozim vendimi i Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e deponisë transfer Komuna Istogut, pjesë e propozuar në sipërfaqe prej (3000) m² në kuadër të parcelës si njësi kadastrale me Nr.P-70806003-00501-0 zona kadastrale në Bellopojë, Komuna Istog, e evidentuar sipas certifikatës pronësore pronë e Komunës së Istogut me sipërfaqe të përgjithshme prej (175334) m².
2. Sipas pikës 1 të këtij Propozim-Vendimi të caktohet pjesa e sipërfaqes me destinim të veçantë e përcaktuar si deponi të materialëve inerte nga pjesa e përgjithshme prej (175334) m² e parcelës P-70806003-00501-0 Zona Kadastrale Bellopojë Komuna Istog në funksion të realizimit të projektit si interes i përgjithshëm publik.
3. Lokacioni sipas pikës 1 të këtij Propozim-Vendimi ka për qëllim realizimin e projektit me interes të përgjithshëm publik për ndërtimin e deponisë transfer me lokacion në Tuqep zona kadastrale Bellopojë Komuna Istog.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në web-faqen zyrtare të Komunës. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdesen : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi si dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shërbime Publike, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

Udhëheqësja e Zyrës Ligjore

Zekije Sutaj



Kryetari i Komunës
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01.Nr.Br.1083/2024	Data: 10.12.2024	

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenin 8 të Statutit të Komunës 01.Nr.62/10 të datës 30.11.2010 i :

Propozon

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 5 shkronja (b),11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14.1 dhe 17 (f) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, të datës 30.11.2010, nenit 4 paragrafi 1.20, nenit 23 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.04/L-60 për Mbeturina, Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-071 Për Mbeturina Rregullores Komunale Nr.1/2023 të datës 27.02.2023; Udhëzimit Administrativ Nr.03/2024 për Kriteret për Zgjedhjen e Lokacionit të Deponive si dhe Kushtet Teknike sipas Destinimit; Ligjit Nr.08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe në bazë të dokumenteve të planifikimit hapësinor të komunës së Istogut pas ri shqyrtimit të vendimit 00Nr.150/2024 të datës 30.11.2024, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2024 të miratojë këtë:

V E N D I M PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT 00.NR.150/2024 PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E DEPONISË TË MATERIALËVE INERTE

1. Miratohet- propozim vendimi i Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e deponisë së materialëve inerte në Tuqep Komuna Istogut, pjesë e propozuar në sipërfaqe prej (23000) m² në kuadër të parcelës si njësi kadastrale me Nr.P-70806003-00501-0 zona kadastrale Bellopojë, Komuna Istog, e evidentuar sipas certifikatës pronësore pronë e Komunës së Istogut me sipërfaqe të përgjithshme prej (175334) m².
2. Sipas pikës 1 të këtij Propozim-Vendimi të caktohet pjesa e sipërfaqes prej (175334) m² e parcelës P-70806003-00501-0 Zona Kadastrale Bellopojë, Komuna Istogut, me destinim të veçantë e përcaktuar si deponi e materialëve inerte nga pjesa e përgjithshme në funksion të realizimit të projektit si interes i përgjithshëm publik.
3. Lokacioni sipas pikës 1 të këtij Propozim-Vendimi ka për qëllim realizimin e projektit me interes të përgjithshëm publik për ndërtimin e deponisë të materialëve inerte me lokacion në Tuqep zona kadastrale Bellopojë Komuna Istog.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në web-faqen zyrtare të Komunës. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi si dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
5. Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shërbime Publike, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, dhe një kopje mbetet në arkivin e kuvendit komunal.

Udhëheqësja e Zyrës Ligjore
Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK ÒPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.Br.1082/2024	Data: Datum: 10.12.2024	

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenin 8 të Statutit të Komunës 01.Nr.62/10 të datës 30.11.2010 i :

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d) nenit 14, paragrafi 14.1 dhe 14.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019); nenit 6, paragrafi 1,2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83, paragrafi 83.1 dhe 83.2 të Statutit 01.Nr.62/2010 të Komunës së Istogut, lidhur me publikimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim që në mbledhjen e mbajtur më: 27.12.2024 të miratojë këtë:

VENDIM

PËR MIRATIM PARAPRAK TË LISTËS TË PËRGJITHSHME TË PRONËS SË PALUJTSHME TË KOMUNËS, DHE LISTEN E VEQANTË TË PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PALNIFIKOHEN PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM

1. **MIRATOHET** *Lista e përgjithshme dhe lista e veçantë* e pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim për vitin 2025.
2. Pjesë e këtij vendimi është *Lista e Përgjithshme dhe lista e Veçantë* e pronave të paluajtshme të Komunës për dhënie në shfrytëzim për vitin 2025 të verifikuara dhe përpiluara nga Komisioni Komunal.
3. Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës do të jetë në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.
4. Dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme të komunës ka për qëllim zhvillimin ekonomik duke respektuar interesin e përgjithshëm publik të Komunës së Istogut.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër, Prone dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, si dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.
6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tije në web-faqen zyrtare të Komunës.

Udhëheqëse e Zyrës Ligjore
Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1081/2024	Data: Datum: 10.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 39 të të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 10.12.2024 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugëve 2 Korriku dhe Liria-projekt 2 vjeçar”; nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugëve 2 Korriku dhe Liria-projekt 2 vjeçar”; me numër të jashtëm prokurimi 633-024-11413-5-1-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-024-087-511 dhe në komision caktohen.

- 1.1. Ata Fetahu,** Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Albert Hasanj,** anëtar dhe;
- 1.3. Blerim Bujupi,** anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugëve 2 Korriku dhe Liria-projekt 2 vjeçar”, me qellim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit t’iu ofroj qasje në oferta që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Ata FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1080/2024	Data: Datum: 10.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 70 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 10.12.2024 të parashtruar nga Prokurimi për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin: “Ndërtimi i rrugëve 2 Korriku dhe Lira-projekt 2 vjeçar”; nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: Menaxheri i kontratës operatori “**P.M.N**” **SH.P.K** për projektin: “Ndërtimi i rrugëve 2 Korriku dhe Lira-projekt 2 vjeçar”; me numër të jashtëm prokurimi 633-024-11413-5-1-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-024-087-511 dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: Genc Ademaj**, Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik , për kontratën e lidhur në mes të Menaxherit të Prokurimit dhe fituesit të tenderit.

2. Menaxheri i kontratave dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratave obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave duke zbatuar A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Prokurimit,
- Operatori “P.M.N” SH.P.K, Menaxher i kontratës,
- Genc Ademaj, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-1078/2024	Data: Datum: 10.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe Nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-40204 të datës 28.10.2024 të parashtruar nga **Valdet Bicaj** nga fshati Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me procesverbal Nr.72/2024 i datës 09.12.2024, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-40204 e datës 28.10.2024 e parashtruar nga **Valdet Bicaj**, për përkrahje financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për blerjen e medikamenteve për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Valdet Bicaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit.
- Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Valdet Bicaj;
- Zyra e Kryetarit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije Sutaj



Kryetari Komunës
 z. Ilir FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1076/2024	Data: Datum: 09.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën të datës 09.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: “Ndërtimi i rrugëve në Dobrushe Sarajeva”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: “Ndërtimi i rrugëve në Dobrushe Sarajeva”, me numër prokurimi 633-024-11405-521/C953, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik **“SHKËMBI” SH.P.K nga Istogu** dhe në komision caktohen:

- 1.1. Rasim Mahmutović,** Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Ardon Arifaj,** anëtar dhe;
- 1.3. Alketa Bytyçi,** anëtare.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.1075/2024	Data: Datum: 09.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13, nenin 17 shkronja k) dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave në Drejtorin për Mirëqenie Sociale, shqyrtoj kërkesën 06-553-42817 të datës 22.11.2024 të parashtruar nga Shukrije Dani, për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas Kontratës për qira 01.Nr.1074/2024 të datës 09.12.2024 dhe me shkresë Nr.79/2024 të datës 03.12.2024, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M


- MIRATOHET:** kërkesa 06-553-42817 e datës 22.11.2024 e parashtruar nga Shukrije Dani, për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas Kontratës për qira 01.Nr.1074/2024 të datës 09.12.2024 dhe ndahen mjete buxhetore për pagesën e qirasë për Shukrije Dani, në shumë prej **900.00€ (nëntëqind euro) për gjashtë (6) muaj.**
- Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro) në muaj, për gjashtë muaj në xhirollogarinë e Shukrije Dani-qiramarrëse nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime nënprogrami buxhetor shërbime sociale, përfutjes individual.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
- Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Shukrije Dani,
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istog Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-1065/024	Data: Datum: 06.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe bazuar në Nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, për Interes të institucionit, shqyrtoj kërkesën 06Nr.232/2024 të datës 19.11.2024, të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, i njoftuar me shkresë edhe Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit, që Marigona Bytyçi, infermiere, të angazhohet me punë shtesë, Koordinatore e Sistemit të Cilësisë të Shërbimeve Shëndetësore në QKMF, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 06Nr.232/2024 e datës 19.11.2024, e parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, i njoftuar me shkresë edhe Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit, që Marigona Bytyçi, infermiere, të angazhohet me punë shtesë, Koordinatore e Sistemit të Cilësisë të Shërbimeve Shëndetësore në QKMF, me Marrëveshje për punën me vëllim të shtuar sipas Nenit 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

2. Marigona Bytyçi, angazhohet në punët shtesë Koordinatore e Sistemit të Cilësisë të Shërbimeve Shëndetësore në QKMF, nga data 01.12.2024 e deri sa të zhvillohen procedurat e rekrutimit, pasi që Koordinatorja ka dal në pension.

3. Obligohet Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime që këtë Vendim dhe Marrëveshjen për punë me vëllim të shtuar të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe Marigona Bytyçi të dërgoj në Ministrinë e Financave Punëve dhe Transfereve-Divizionit të Pagave për ndryshimin në pagë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Marigona Bytyçi, Menaxheri Personelit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimit i bashkëngjitet Marrëveshja për punë me vëllim të shtuar.

Vendimi i dërgohet:

- Marigona Bytyçi,
- Fisnik Shoshaj,
- Emina Coković, Zyrtare Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.1064/024	Data: Datum: 06.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit 03/L 040 për Vetëqeverisjen Lokale, në Nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në Nenin 35 të Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.21/2023) në fuqi nga 18 shtatori 2023 dhe në Nenin 68 të Statutit 01Nr.62/2010 të Komunës së Istogut i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 13Nr.96/2024 të datës 05.12.2024, të parashtruar nga Genc Ademaj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, i njoftuar me shkresë edhe Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit, për caktimin e Ushtruesit të Detyrës të Udhëheqësit të Sektorit për Tatim në Pronë dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1.MIRATOHET:** kërkesa 13Nr.96/2024 e datës 05.12.2024, e parashtruar nga Genc Ademaj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, i njoftuar me shkresë edhe Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit, për caktimin e Ushtruesit të Detyrës të Udhëheqësit të Sektorit për Tatim në Pronë, pasi që Udhëheqësja e Sektorit për Tatim në Pronë ka dal në pension dhe pozita e punës është e lirë .
- Ushtrues Detyre të Udhëheqësit të Sektorit për Tatim në Pronë caktohet: Besnik Metaj, Zyrtar i Lartë i Tatimit në Pronë, për gjashtë (6) muaj, i cili ushtron detyrën e Udhëheqësit nga data 01.12.2024.
- Mbas përfundimit të afatit të cekur në pikën 2. të këtij Vendimi, nëpunësi civil i cekur kthehen në pozitën e mëparshme sipas paragrafit 5 të nenit 35 të Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.
- Obligohet Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime që këtë Vendim të dërgoj në Ministrinë e Financave Punëve dhe Transfereve-Divizionit të Pagave, për futjen e Besnik Metaj në listën e pagave Ushtrues Detyre në pozitën e punës: Udhëheqës i Sektorit për Tatim në Pronë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Menaxheri i Personelit, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime dhe Besnik Metaj.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Genc Ademaj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, i njoftuar me shkresë edhe Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit, ka parashtruar kërkesën 13Nr.96/2024 të datës 05.12.2024, për caktimin e Besnik Metaj, Ushtrues Detyre të Udhëheqësit të Sektorit për Tatim në Pronë.

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës së lartpërmendur, e miratoj propozimin e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për caktimin e Besnik Metaj, Ushtrues Detyre të Udhëheqësit të Sektorit për Tatim në Pronë, për gjashtë (6) muaj, nga data 01.12.2024, pasi që Udhëheqësja Sektorit për Tatim në Pronë, ka dal në pension dhe pozita është e lirë.

Mbas përfundimit të afatit të cekur në pikën 2. të këtij Vendimi, Besnik Metaj kthehet në pozitën e mëparshme sipas paragrafit 5 të nenit 35 të Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Besnik Metaj,
- Fisnik Shoshaj,
- Genc Ademaj,
- Emina Coković- Zyrtare Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqësja e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ





 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PËRSEDNIK OPŠTINË MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1063/2024	Data: Datum: 06.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 08Nr.488/2024 të datës 06.12.2024 të parashtruar nga Drejtori e Drejtorisë për Shërbime Publike, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: Lot4 “Ndërtimi i kanalizimit në Shushicë të Ulët lagja Aliaj, Nimanaj, Nekaj, Ademaj dhe Jahaj”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: Lot4 “Ndërtimi i kanalizimit në Shushicë të Ulët lagja Aliaj, Nimanaj, Nekaj, Ademaj dhe Jahaj”, me numër të jashtëm prokurimi 633-024-4644-52-1/C888, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik “LURN” SH.P.K. Komuna e Istogut dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Naser Nimanaj**, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Hekuran Rugova**, anëtar dhe;
- 1.3. **Haki Belaj**, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës dhe Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1062/2024	Data: Datum: 06.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën Nr.07/2024 e datës 06.12.2024 të parashtruar nga Osman Sadikaj, Auditor i Brendshëm- I transferuar përkohësisht, për përkrahje me karburant, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.07/2024 e datës 06.12.2024, e parashtruar nga Osman Sadikaj, Zyrtar Kryesor Financiar, për përkrahje me karburant, për shkuarje në kontroll të mjekët në Tiranë-Republika e Shqipërisë dhe përkrahjet **me 75 litra karburant**, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.

2. Obligohet Zyrtari i transportit që Osman Sadikaj, të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant si në pikën 1. të këtij Vendimi. Vërtetimi i lëshohet për veturë private FORD RANGER me tagra te regjistrimit: 03-245-HD, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Zyrtari i Transportit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Osman Sadikaj,
- Zyrtarit Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1061/2024	Data: Datum: 05.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në Nenin 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja, në fuqi nga data 01.11.2022, dhe bazuar në Vendimin e Njësisë së Prokurimit Publik në Istog, të datës 05.12.2024 të nxjerr mbi bazën e njoftimit të aprovimit të ankesës nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të datës 25.11.2024 për rishqyrtimin e aktivitetin të prokurimit me titull “Demolimi dhe largimi i objekteve të pa përdorshme”, shqyrtoj kërkesën të datës 05.12.2024 të parashtruar nga Prokurimi, për themelimin e Komisionit Rivlerësues të tenderit për projektin: “Demolimi dhe largimi i objekteve të pa përdorshme”, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni Rivlerësues i tenderit për projektin: “Demolimi dhe largimi i objekteve të pa përdorshme”, me numër të jashtëm prokurimi 633-024-9470-521 e numër të brendshëm prokurimi 633-024-065-521 dhe në komision caktohen.

- 1.1. Naser Nimanaj,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Nexhat Avdijaj,** anëtar;
- 1.3. Hysen Mehmetaj,** anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë Rivlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit për projektin: “Demolimi dhe largimi i objekteve të pa përdorshme”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit Rivlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit Rivlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit t’iu ofroj qasje në oferta që kanë shprehur konkurrencë.


7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Inspektion .

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Inspektion dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1060/2024	Data: Datum: 05.12.2024	

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13. dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 dhe Rregullores për Ndarjen Bursave për Studentë Nr.135/2022), shqyrtoj kërkesën 05.Nr.924/24 të datës 05.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensimin e 66 studentëve të cilët janë përfitues të bursave për vijimin e studimeve 2023/2024 dhe propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** Kërkesa 05.Nr.924/24 e datës 05.12.2024 e parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensimin e 66 studentëve të cilët janë përfitues të bursave për vijimin e studimeve 2023/2024.
- Kompensohen 61 bursistë të ri dhe 5 bursistë të bartur nga viti paraprak nga fondi burimor 21 nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere-programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim në vlerë prej 44,300.00€.
- Mjetet e përcaktuara, në pikën 2. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogaritë e studentëve përfitues të bursave nga Drejtoria Komunale për Arsimit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Zyrtari i Lartë Financiar.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë Komunale të Arsimit,
- Zyrtarit Lartë Financiar-përgjegjës për kompensimin e studentëve dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
 z.Illir FERATI




 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1059/2024	Data: Datum: 05.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e datës 05.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektet: Lot3 “Ndërtimi i rrugës “Beke Salihu” në Dubrave; Lot4 “Ndërtimi i rrugëve në Istog të Poshtëm”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektet: Lot3 “Ndërtimi i rrugës “Beke Salihu” në Dubrave; Lot4 “Ndërtimi i rrugëve në Istog të Poshtëm”, me numër prokurimi 633-024-8551-521/929, të cilat projekte i ka realizuar operatori ekonomik **“GRANIT” SH.P.K.** dhe në komision caktohen:

- 1.1. Rasim Mahmutović,** Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Ardon Arifaj,** anëtar dhe;
- 1.3. Visar Alihajdaraj,** anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projekteve të cekura në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektet e lartcekura si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektet e lartcekura e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës dhe Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë Ekonomi dhe Zhvillim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. 1058/2024	Data: Datum: 09.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016) dhe në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, e ka shqyrtuar kërkesën 06 Nr. 553-29065 të datës 08.08.2024, të parashtruar nga Šefik Eço nga fshati Banje, Komuna e Istogut, përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e tij, në QKUK - Prishtinë, Komisioni me procesverbal Nr. 303/2024 të datës 02.12.2024, i propozon Kryetarit, të nxjerr:

V E N D I M

- 1. APROVOHET:** Kërkesa 06 Nr. 553-29065, datë 08.08.2024, e parashtruar nga Šefik Eço, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e tij, në QKUK - Prishtinë, për trajtimin me Radio-Terapi, në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas. I lejohen 60 litra lëndë djegëse (karburant) për 6 seanca.
- Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë Šefik Eço, me një vërtetim për furnizim me karburant të automjetit që parashtruesi i kërkesës e prezanton, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi. Ky furnizim duhet të bëhet në përputhje me procedurat e furnizimit me karburant të automjeteve zyrtare që vlen në programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij. Për zbatimin e tij do të përzgjidhen Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
- Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë një konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Šefik Eço,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije Sutaj





 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1056/2024	Data: Datum: 04.12.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për përkrahje financiare në Drejtorinë për Administratë Komunale, shqyrtoj kërkesën 02Nr.016-43120/2024 të datës 29.11.2024, të parashtruar nga Rexhë Mulaj, përfaqësues i OJQ “Vision 02”, nga Gurakoci, për përkrahje financiare për realizimin e projektit: “Hartimi i Planit të Veprimit të OJQ “Vision 02” për vitin 2025-2028, me Procesverbal 02Nr.121/2024 të datës 03.12.2024 i propozon Kryetarit për miratim dhe Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale me kërkesë 02Nr.122/2024 të datës 03.12.2024, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 02Nr.016-43120 e datës 03.12.2024 e parashtruar nga OJQ “Vision 02”, për përkrahje financiare për realizimin e projektit: “Hartimi i Planit të Veprimit të OJQ “Vision 02” për vitin 2025-2028 dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga nën programi buxhetor i barazisë gjinore.

2. Mjetet e ndara në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ-së “Vision 02” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Regjë Mulaj, OJQ”Vision 02”,
- Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1055/2024	Data: Datum: 04.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 12Nr.116/2024 të datës 04.12.2024 të parashtruar nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: “Ndërtimi i Qendrës Rinore në Staradran”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: “Ndërtimi i Qendrës Rinore në Staradran”, me numër të brendshëm prokurimi 633-024-027-521, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik “**AXIS G.C.W**” SH.P.K. nga Banja Komuna e Istogut dhe në komision caktohen:

- 1.1. Hekuran Rugova,** Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Naser Gjocaj,** anëtar dhe;
- 1.3. Qefsere Ibrahimaj,** anëtare.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës dhe Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
Ilir FERATI




 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1054/2024	Data: Datum: 03.12.2024	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e datës 03.12.2024 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: “Renovimi i kulmit, klasave dhe njejve sanitare në shkollën fillore “Martin Camaj” -Serbobran, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: “Renovimi i kulmit, klasave dhe njejve sanitare në shkollën fillore “Martin Camaj” -Serbobran, me numër të brendshëm prokurimi 633-024-031-521, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik “**AXIS**” SH.P.K. nga Fushë Kosova dhe në komision caktohen:

- 1.1. Mimoza Kabashi,** Kryesuese e Komisionit,
- 1.2. Naser Nimanaj,** anëtar;
- 1.3. Besnik Ramaj,** anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin e punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës dhe Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ